



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.376/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar, Mejreme Memaj e Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit Ç. B., me vendbanim në rrugën “I. P. D.”, pn., në P., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 pika 1.4 e 1.6 lidhur me nenin 28 e 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesën e të dëmtuarit M. H. për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.255/2023 datë 5 dhjetor 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 21 qershor 2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

Hedhet si e papranueshme kërkesa e të dëmtuarit M. H. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.255/2023 datë 5 dhjetor 2023.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.255/2023 datë 5 dhjetor 2023, të pandehurin Ç. B., e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, parashikuar me nenin 173 par.1 pika 1.4 e 1.6 lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK, dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK, dhe për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë e ka gjykuar me pesë (5) vite e tre (3) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 11.03.2023 e tutje, për veprën penale të armëmbajtjes me dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500)€. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë e njëjta do ti zëvendësohet me burgim, ashtu që në një ditë burgimi do ti llogariten 20€ të gjobës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Krimeve të Rënda, duke vendosur përkitazi me ankesën e të dëmtuarit M. H. me aktgjykimin PAKR.nr.2/24 datë 6 mars 2024, e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve të lartcekura ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë i dëmtuari M. H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë

ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme ta aprovojë kërkesën dhe aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, kurse çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.

Kryeprokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.215/2024 datë 20 qershor 2024, ka propozuar që kërkesa të hedhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, dhe vlerësoi pranueshmerinë e kërkesës, konstatoi:

Kërkesa është e papranueshme.

Sipas dispozitës së nenit 433 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqes Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes se të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424 par.1 të këtij kodi (prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini gjaku në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit).

Në rastin konkret ka paraqitur kërkesë i dëmtuari, kurse, bazuar në dispozitën e lartcekur del se i dëmtuari nuk ka të drejtë ta paraqes këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, prandaj, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa është e papranueshme.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 435 par. 2 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**  
PML.nr.376/2024, me 21 qershor 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,  
Afrim Shala